

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, nëpërmjet gjyqtarit të vetëm gjykues Sabedin Mushica, me zyrtaren ligjore Adelina Brestovci, në çështjen penale ndaj të pandehurit \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_, Rruga " \_\_\_\_\_ " pn, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378, paragrafi 6, lidhur me paragrafin 1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës,<sup>1</sup> sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1686/2014, të datës 17 nëntor 2014, të cilën e përfaqësonte prokurorja e shtetit Huma Jetishi, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 12.04.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri \_\_\_\_\_, nga babai \_\_\_\_\_ dhe nëna \_\_\_\_\_, e lindur \_\_\_\_\_, i lindur më datë \_\_\_\_\_, në fshatin \_\_\_\_\_, Komuna e \_\_\_\_\_, me vendbanim në Gjilan, rruga " \_\_\_\_\_ "pn, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, ka të kryer shkollën fillore, punëtor në furrën " \_\_\_\_\_ ", në \_\_\_\_\_, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër të letërnjoftimit ID \_\_\_\_\_.

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë 01.08.2014, rreth orës 16:30 min, në Gjilan, përballë pikës së karburanteve " \_\_\_\_\_ ", që gjendet në rrugën Gjilan-Malishevë, i akuzuari \_\_\_\_\_, duke drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës \_\_\_\_\_, me targa të regjistrimit \_\_\_\_\_, në rrugën \_\_\_\_\_, ka vepruar në kundërshtim të dispozitës ligjore 54.5, të LSKRRK-së, ashtu që nuk ka përshtatë shpejtësinë e lëvizjes, kushteve në rrugë, për ta ndalur automjetin, para çdo pengese që paraqitet në rrugë, ku në lëvizje e sipër, me pjesën e përparme e godet në pjesën e prapme automjetin tjetër para tij të markës \_\_\_\_\_, me targa të regjistrimit \_\_\_\_\_, të cilën e drejtonte \_\_\_\_\_ nga fshati \_\_\_\_\_, Komuna e \_\_\_\_\_, e që në momentin kritik ishte duke lëvizur në drejtimin e njëjtë të rrugës dhe si pasojë e këtij aksidenti, përpos dëmeve materiale të shkaktuara në të dy automjetet, lëndime të lehta trupore kanë pësuar pasagjeret \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_, të cilat për shkak të natyrës së lëndimeve trupore janë detyruar të kërkojnë ndihmë mjeksore në Emergjencën e Spitalit Regjional të Gjilanit.

-Me çka ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378, paragrafi 6, lidhur me paragrafin 1, të KPRK-së.

<sup>1</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), nr.04/L-082, i datës 20 prill 2012, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

P/4

Andaj, gjyqtari i vetëm gjykues, në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 43, 46, 73,74 dhe 76,të KPRK, si dhe nenit 248 dhe nenit 365, të Kodit të Procedurës Penale,<sup>2</sup> të pandehurit \_\_\_\_\_, i shqipton:

### DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të pandehurit \_\_\_\_\_, i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro), të cilin dënim i pandehuri do t'a paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita pasuese kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i pandehuri, refuzon që të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje t'a paguajë atë, atëherë gjykata, me pajtimin e të pandehurit, mund t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë me punë në dobi të përgjithshme. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë me punë në dobi të përgjithshme, gjykata do të cakton 1 (një) ditë burgim për çdo 20 € (njëzetë Euro) të dënimit me gjobë.

Palët e dëmtuara \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_, që të dytë nga fshati \_\_\_\_\_, Komuna e \_\_\_\_\_, për realizimin e kërkesës pasuroro juridike, udhëzohen në kontest civil.

Detyrohet i pandehuri që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej nga 25 € (njëzet e pesë Euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita pasuese kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

### ARSYETIMI

#### 1. Ecuria e procedurës

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit \_\_\_\_\_, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378, paragrafi 6, lidhur me paragrafin 1, të KPRK-ës.

#### 2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores Huma Jetishi, i pandehuri \_\_\_\_\_, ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas dëgjimit të palëve dhe të dëmtuarës, ka marrë aktvendim për pranimin e fajësisë, ngase ka ardhur në përfundim se i pandehuri e ka kuptuar natyrën

<sup>2</sup> Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejme KPP), nr.04/L-123, i datës 13 dhjetor 2012, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri dhe se pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret, të cilat janë paraqitur së bashku me aktakuzë dhe nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafi 1 të KPP.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se i pandehuri \_\_\_\_\_, nga pakujdesia e ka kryer veprën penale të lartcekur, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4. Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues ka vendosur që të pandehurin \_\_\_\_\_, ta shpallë fajtorë për kryerjen e veprës penale sipas dispozitivit I, ngase, veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtin është penalisht përgjegjës.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Duke u bazuar në nenin 73 dhe 74 të KPRK, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit \_\_\_\_\_ gjyqtari i vetëm gjykues i ka marrë për bazë disa rrethana që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese për të pandehurin gjyqtari i vetëm gjykues ka marrë për bazë sjelljet e mira të të njëjtit gjatë shqyrtimit fillestar; pranimin e fajësisë; se i njëjti është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale; se ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë vepër tjetër penale; i njëjti është i moshës së re, njëashtu e dëmtuara \_\_\_\_\_ ka deklaruar se nuk i bashkangjitem ndjekjes penale dhe njëashtu nuk kërkon kërkesë pasuroro juridike, ndërsa si rrethanë rënduese, gjykata e mori për bazë shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprave penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues, dënimi me gjobë ndaj të akuzuarit \_\_\_\_\_ duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e

veprës penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Zëvendësimi i dënimit me gjobë

Gjyqtari i vetëm gjykues duke u bazuar në nenin 46 të KPRK, ka vendosur që nëse i pandehuri refuzon që të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje t'a paguajë atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme, ashtu që 8 (tetë) orë të punës në dobi të përgjithshme do të barazohen me 20 (njëzet) Euro, të dënimit me gjobë. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë, do të caktohet nga një ditë burgim.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesën pasurore juridike


Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurit, gjyqtari i vetëm gjykues, duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të akuzuarin t'a detyrojë për ta paguar vetëm paushallin gjyqësor prej 25€ (njëzet e pesë Euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë

Duke u bazuar në nenin 458, të KPP-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ku palët e dëmtuara edhe atë \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ i ka udhëzuar që kërkesën pasuroro juridike ta realizojnë në kontest civil.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
P.nr.994/2014  
Më 12 prill 2018

Zyrtare ligjore,  
Adelina Brestovci



Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Sabedin Mushica



**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.